



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:124182

Datë: 31.05.2023

Numri i dokumentit: 04344858

P.nr.1500/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i përgjithshëm- Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Ertan Sejfulla, me praktikantin Lorik Kolshi, në çështjen penale kundër të akuzuarës K.Z., për shkak të veprës penale: Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430, paragrafi 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2667/22, të datës 16.02.2022, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, më datë 31.05.2023, jashtë seancës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2667/22, të datës 16.02.2022 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

E akuzuara: K.Z. e bija e e lindur me dt., në, me vendbanim në, me numër personal,Këshilltare, dhe, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës

ËSHTË FAJTORE

S e p s e: Në cilësinë e zyrtarit të lartë publikë, si Këshilltare, dhe,, e pandehura K.Z. me dashje ka vepruar në kundërshtim me nenin 5 par. 1 të Ligjit për Deklarim, Prejardhjen dhe Kontrollimin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik, në atë mënyrë që e njëjta edhe pse ka qenë e obliguar të bëjë deklarin e pasurisë, në afatin e parapare ligjor (brenda 30 ditëve), e njëjta nuk e ka deklaruar pasurinë brenda këtij afati, përkatësisht nga 01 mars deri me 31 mars të vitit 2022, për vitin paraprak nga 1 janari deri me 31 dhjetor të vitit 2021,-

- Me këtë ka kryer veprën penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 të KPRK, si dhe neneve 364 dhe 495, të KPP-së, të akuzuarës i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej **500.00 (pesëqind) €**, të cilin dënim e akuzuara është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par 3 të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

I njëjti dënimin e shqiptuar mund të paguajë, me 2 (dy) këste. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.

Obligohet e akuzuara që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për paushallin gjyqësor në shumë prej 30.00 (tridhjetë) €, në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 20.00 (njëzet) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2667/22, të datës 16.02.2022, ndaj të akuzuarës K.Z, për shkak të veprës penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430, paragrafi 1 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjykata pasi shqyrtoi përmbajtjen e aktakuzës dhe kërkesës për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor nga ana e organit të ndjekjes, gjeti se të njëjtat janë përpiluar në përputhje me nenin 493 të KPP-së, andaj erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet nga neni 495 i KPP-së, që në këtë çështje penale pa u mbajtur fare shqyrtimi gjyqësor të marrë vendim për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor ndaj të pandehurit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: Formulari për Deklarimin e pasurisë e zyrtares së lartë K.Z, e datës 04.04.2022, me numër protokollit 03/5818/22 se bashku me sqarimin e saj për vonesë për deklarimin e pasurisë; Njoftimin Publik i AKK për fillimin e procesit të deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë, i datës 28.02.2022; Njoftimin elektronik i AKK, i datës 01.03.2022, 28.03.2022, drejtuar zyrtarëve kontaktues për

fillimin e procesit të rregullt vjetor të pasurisë; Shkresat e zyrtarit kontaktues / lista e zyrtareve të Komunës së Dragashit; Shkresat elektronike e zyrtarit kontaktues, përcjellë zyrtarëve të lartë publik në lidhje me njoftimin për fillimin e procesit të deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë, e datës 01.03.2022 dhe 28.03.2022; Sqarimi i zyrtares K.Z rreth mos deklarimit të pasurisë brenda afatit ligjor, si dhe shkresat e tjera të lëndës, mbi bazën e të cilës vërtetohet se e pandehura ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lartë, gjykata konstaton se e akuzuara, është penalisht përgjegjëse për kryerjen e veprës penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430, paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim të nenit 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, që në të ardhmen të akuzuarit të kenë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngrit moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të Ligjit nr.08/L-109.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 364 e 495, të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal

P.nr.1500/22, i dt.31.05.2023

Praktikanti,
Lorik Kolshi

Gj y q t a r i
Ertan Sejfulla

KËSHILLË JURIDIKE: I akuzuari ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.